



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Ligjshmërisë

Datë	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

“PËR MATERIALET ZGJEDHORE DHE DOKUMENTACIONIN E PUNËS QË DO TË PËRDOREN NË ZGJEDHJET PËR KRYETARIN E BASHKISË RROGOZHINË, TË DATËS 23 KORRIK 2023”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Në referim të nenit 99 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë, para datës së zgjedhjeve, materialet zgjedhore të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim hartohet në kuadër të përgatitjeve, të zhvillimit dhe të administrimit të procesit zgjedhor, për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë që do të zhvillohen në datën 23 Korrik, dhe ka për qëllim të përcaktojë karakteristikat e materialeve zgjedhore që do të përdoren, si dhe dokumentacionin e punës.

Materialet zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, do të plotësojnë karakteristikat e përcaktuara në vendimin nr. 223, datë 7.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim”.

Për vendosjen e materialeve zgjedhore do të përdoren kutitë e votimit, kapaku i të cilave do të jetë i vulosur me kodin e pestë nga KQZ dhe të identifikuar me shenja dalluese si kuti të materialeve zgjedhore.

KZAZ-të dhe KQV-të do të përdorin dokumentacionin e punës të prodhuar për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, me shënimin me ngjyrë të kuqe “Përsëritje e Zgjedhjeve për Kryetar Bashkie 23.7.2023”.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për materialet zgjedhore dhe dokumentacionin e punës që do të përdoren në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 Korrik 2023”.

Erion META – Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore
Madalena KOJA - Drejtoria e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA – Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve
Aurel LAMÇE - Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve
Mbështetëse
Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë: 7.7.2023

Nr:

Ora: 12:30

PROJEKTVENDIM

PËR

**MATERIALET ZGJEDHORE DHE DOKUMENTACIONIN E PUNËS QË DO TË PËRDOREN NË ZGJEDHJET
PËR KRYETARIN E BASHKISË RROGOZHINË, TË DATËS 23 KORRIK 2023**

Në mbështetje të nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe të nenit 99, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOS:

1. Në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë do të përdoren materialet zgjedhore që plotësojnë karakteristikat e përcaktuara në vendimin nr. 223, datë 7.12.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim”.
2. Për vendosjen e materialeve zgjedhore do të përdoren kutitë e votimit, kapaku i të cilave do të jetë i vulosur me kodin e pestë nga KQZ, dhe të identifikuara me shenja dalluese si kuti të materialeve zgjedhore.
3. KZAZ-të dhe KQV-të do të përdorin dokumentacionin e punës, të prodhuar për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, me shënimin me ngjyrë të kuqe “Përsëritje e Zgjedhjeve për Kryetar Bashkie 23.7.2023”.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Datë: 7.7.2023 Nr:
Ora: 12:30



“Për materialet zgjedhore dhe dokumentacionin e punës që do të përdoren në zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë, të datës 23 korrik 2023”